



K.DH.SH.II.nr.99/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, kryetare e kolegjit, Krenar Berisha dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “K... L...” D.O.O, me seli në Mitrovicë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Zyhdi Axhemi, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK), në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.895/17, të datës 05.02.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 15.12.2022, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit “K... L...” D.O.O, me seli në Mitrovicë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.895/17, të datës 05.02.2020, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e ankimuar është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit “K... L...” D.O.O, me seli në Mitrovicë, ndërsa ka mbet në fuqi vendimi i Doganës së Kosovës nr.06.2/187, i datës 27.04.2017.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar paditësi përmes të autorizuarit të tij, për shkak të konstatimit jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të dispozitave materiale dhe procedurale që kanë rezultuar në pagesën shtesë të detyrimeve të importit, me propozim që ankesa të aprovet në tërësi si e bazuar, të anulohet në tërësi si i pa bazuar

aktgjykimi A.nr.895/17, të datës 05.02.2020 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA, nenit 81.G të Ligjit për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurën nr.03/L-222 dhe nenit 194 i LPK-së, në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me Aktvendimin nr.06.2/187, i datës 27.04.2017, ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e subjektit në procedurë “K... L...” D.O.O, me seli në Mitrovicë, të ushtruar ndaj aktvendimit nr.04.1-2017-35 të datë 06.02.2017 të Sektorit të Kontrollës Pas-Importues, si e pa bazuar.

I pakënaqur me aktvendimin e Doganës së Kosovës, subjekti tani paditësi, ushtron padi në procedurë të konfliktit administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje, Administrative-Divizion Fiskal. Gjykata e shkallës së parë në këtë çështje, mbanë seancë të shqyrtimit kryesor me datë 05.02.2020, në prani të palëve ndërgjyqëse dhe pas administrimit të provave gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur dhe vërtetimit të gjendjes faktike, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, ndërsa e len në fuqi aktvendimin e organit të paditur, me arsyetim se nga provat e administruara në konfliktin administrativ, Gjykata nga DUD-at kontestues, deklarimeve në ankesë, aktvendimi kontestues ka nxjerr konstatimin se Sektori i Kontrollit pas importues ka ushtruar kontroll dokumentare tek subjekti “K... L...” D.O.O me seli në Mitrovicë nën dyshimin se për mallin e importuar gabimisht është liruar nga taksat doganore importuese sipas marrveshjes së CEFTA-s. Andaj si rrjedhojë Sektori i Kontrollit pas Importues duke u bazuar në nenin 82 dhe 219 të KDA-së, me qëllim të rregullimit të situatës ka bërë ndryshimin e deklaratave doganore dhe ka obliguar subjektin në procedure që për Deklaratat Doganore Unike nr. IM4 R-2966/16.05.2015 dhe R-5238/08.09.2015 të paguaj obligimet doganore në shumë prej 3,840.49€. Pasi që në rastin konkret e paditura ka konstatuar se subjekti nuk e ka deklaruar mallin sipas dispozitave në fuqi duke e liruar mallin nga taksat doganore, pra nuk ka bashkangjitur EUR-1 ose deklaratë faturë, e të cilat dokumente kërkohen në rastin e importit të mallrave që përfitojnë trajtim favorizues sipas marrveshjes së CEFTA.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë. Kolegji i kësaj gjykate, vlerëson se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje sipas pretendimeve ankimore, as me shkelje qenësore të dispozitave të LKA-së, dhe të LPK-së, të cilat kolegji i vlerëson sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar drejtë ligjshmërinë e aktit përfundimtar-aktvendimit të ankimuar nga paditësi, si në vështrim të nenit 81G të Ligjit nr. 04/L-102 si dhe Ligjit 03/L-222, me të cilin në procedurë administrative, e gjithashtu sipas aktgjykimit ankimor edhe në procedurë gjyqësore, në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike, ashtu që Sektori i Kontrollës Pas Importuese ka vërejtur se malli është liruar nga taksa doganore por që nuk ka prezantuar certifikatë EUR1 si dhe nuk ka deklarim fatural të origjinës, pra në faturë nuk është shënuar klauzola për deklarim fatural të origjinës që dëshmon origjinën e mallit, ashtu siç parashihet me marrëveshjen CEFTA, dhe si rrjedhojë Sektori i Kontrollit pas Importues ka obliguar subjektin në procedurë të paguaj obligimet doganore në shumë prej 3,840.49€. Andaj kolegji i kësaj gjykate vlerëson se e paditura ka vepruar drejtë duke aplikuar dispozitën e nenit 82 të KDA-së, e cila dispozitë përcakton se: “1. Dogana sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të deklaruesit e rishqyrton deklaratën pas lirimit të mallit. 2. Dogana, pasi ta ketë lejuar lirimin e mallrave dhe më qëllim që të sigurohet për të dhënat e vërteta të deklaruara, në deklaratën doganore, mund të kontrollojë dokumentet tregtare dhe të dhënat që kanë të bëjnë me importin apo eksportin, si dhe veprimet pasuese (të mëvonshme) tregtare që kanë të bëjnë me këto mallra. Ky kontroll mund të kryhet në ambientet e deklaruesit ose të çdo personi, drejtpërdrejt ose tërthorazi të përfshirë në veprimet e mësipërme për arsye të veprimtarisë së tij ose të çdo personi tjetër në posedimin e të cilit janë dokumentet e lartshënuara për qëllime tregtie. Dogana, po ashtu mund të kontrollojë edhe mallrat kur paraqitja e tyre është ende e mundur. 3. Pa rënë ndesh me nenin 219.3, kur nga rishqyrtimi i deklaratës ose kontrollit pas zhdoganimit gjen se dispozitat që rregullojnë procedurën doganore përkatëse janë zbatuar në bazën e të dhënave jo të sakta apo jo të plota, Dogana, në përputhje me dispozitat në fuqi, do të ndërmer masat e duhura për të rregulluar situatën e krijuar, duke i marrë parasysh edhe informatat e reja që janë në dispozicion”.

Pretendimet ankimore të paditësit sipas shkaqeve ankimore si dhe theksimet e tjera në arsyetim të ankesës, kolegji i shqyrtoi në tërësi si në baza ligjore dhe i refuzon si të pabazuara, sepse gjendja faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë është vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë e po ashtu në mënyrë të drejtë janë zbatuar dispozitat ligjore procedurale të LKA-së, LPK-së, si dhe dispozitat e ligjit material të KDA-së, ku pa dyshim vërtetohet se paditësi ka dështuar të paraqes EUR1 si provë që dëshmon origjinën e mallit, i cili dokument kërkohet në bazë të marrëveshjes së CEFTA-s e cila aplikohet edhe në rastin konkret, përkatësisht neni 16 “Vërtetimi i Origjinës, kërkesat e përgjithsme” “Produktet me origjinë në një palë gjatë importimit në palën tjetër, përfitojnë nga kjo marrëveshje me paraqitje të një çertifikate qarkullimi mallrash EUR 1, në eksemplar i së cilës tregohet në aneksin III ose një deklaratë faturë. Andaj me që malli pas përfundimit të procedurës doganore dhe vendosjes së mallit në qarkullim të lirë, Dogana e Kosovës pas konstatimit se subjekti nuk ka deklaruar mallin sipas dispozitave në fuqi duke e liruar mallin nga taksat doganore, ka ndërmarr masa me qëllim të rregullimit të situatës, ku ka bërë kontrollimin e deklaratave pas importit dhe pas ndryshimit të deklaratave doganore e ka obliguar subjektin në procedure që të paguaj detyrimet doganore shtesë.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pandikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, Andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.99/22, me datë 15.12.2022

**Kryetare e kolegjit,
Franciska Zhitija Ymeri**